

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/22
Prishtinë,më 4 shtator 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram **Kosumi**,anëtar i Kryesisë.
Kryesusi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Kryesia i kishte propozuar Kuvendit këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për siguri në punë,mbrojtje të shëndetit dhe mjedisit të punës;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës-nr.2002/9;dhe
4. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare që do të mbahet më 11 shtator 2003.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit miratimin e rendit të ditës.

Sabri Hamiti- në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së propozoi që Kuvendi i Kosovës në mbledhjen e ardhshme ta shqyrtojë deklaratën e Kuvendit të Serbisë lidhur me përfshirjen e Kosovës në Kushtetutën serbe, si territor të saj.

Arsim Bajrami-në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së propozoi që Kuvendi i Kosovës,në seancën e sotme, t'i shqyrtojë zhvillimet aktuale politike dhe të sigurisë.

Bujar Dugolli- në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së propozoi që Kuvendi,në seancën e sotme të deklarohet lidhur me nismën e 42 deputetëve për shpalljen e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Ibush Jonuzi- propozoi që Kuvendi,në seancën e sotme,ta shqyrtojë grevën e minatorëve të StanTërg dhe t'i prpozojë Qeverisë,UNMIK-ut dhe AKM-së që të përgatisin propozime konkrete për zgjidhjen e çështjes së minatorëve.

Kryesuesi- kërkoi mirëkuptim nga deputetët e Kuvendit që të arrihet një koncenzues i unitetit veprues lidhur me çështjet që ata i shtrojnë,ngase ato janë të arsyeshme,por të mos nxitohet me shtruarjen e tyre pa u bërë përgatitjet e nevojshme.Ai deklaroi një pauzë prej 20 minutave për tu konsultuar me kryetarët e grupeve parlamentare lidhur me kërkesat e parashtruara.

Pas pauzës,kryesuesi tha se kryetarët e grupeve parlamentare janë pajtuar që seanca e sotme të vazhdojë me rendin e ditës së paraparë,por për çështjet që ata sot i shtruan duhet të përgatiten dhe të shqyrtohen në Kryesi,pastaj të radhiten për seancat tjera,kurse Arsim Bajrami nuk është pajtuar me këtë dhe ka kërkuar që të vëhët në votim propozim i tij.

Kryesuesi e vuri në votim propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së,por Kuvendi me shumicë votash,nuk e miratoi atë propozim.

1. Miratimi i procesverbalit i seancës të mëparshme.

Nuk pati vërejtje lidhur me procesverbalin e seancës të mëparshme dhe ai u miratua.

2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për siguri në punë,mbrojtje të shëndetit dhe të mjedisit të punës-nr.2003/20;

Kryesuesi e ftoi ministrin e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale,që ta arsyetonte këtë P/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ahmet Isufi – e arsyetoi para deputetëve nevojën e nxjerrjes së këtij P/ligji,ngase sipas tij,siguria në punë dhe mbrojtja e shëndetit të të punësuarëve nuk është në nivelin e duhur,si pasojë e infrastrukturës së dobët,pajisjeve teknike të stërvjtuara dhe të pamirëmbajtura.Prandaj,përmirësimi i kushteve të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së shëndetit të punësuarëve,është detyrë urgjente,shtoi ministri Isufi.

Për të krijuar kushte të përshtatshme të punës dhe mbrojtje të punëtorëve nga aksidentet e mundshme dhe sëmundjet e shkaktuara nga puna,shtoi ai, është e domosdoshme nxjerrja e këtij ligji që është i bazuar në standardet ndërkombëtare që e normojnë këtë fushë.

Qëllimi kryesor i këtij p/ligji është mbrojtja e shëndetit,parandalimi i lëndimeve dhe smundjeve në vendin e punës dhe mbrojtjen e mjedisit të punës.

Ky p/ligj i parasheh edhe obligimet e përgjithshme të punëdhënsit dhe të punëmarrësit për të garantuar sigurinë dhe shëndetin në punë. Sipas këtij p/ligji detyrat më të mëdha për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e shëndetit të të punësuarve i ka punëdhënsi, por nuk mungojnë as detyrimet që i ka punëmarrësi. Punëdhënsit janë të obliguar që të krijojnë kushte të volitshme të punës, pajisjen me makineri të përshtatshme për punë, organizimin e trajnimeve të nevojshme të personelit etj. Kurse punëtorët janë përgjegjës për monitorimin e masave të sigurisë dhe të shëndetit dhe të bashkëpunojnë me punëdhësit në këtë fushë.

Ky p/ligj i parasheh edhe masat e veçanta për mbrojtjen e personave nën moshën 18 vjeçare, të femrave dhe të personave me aftësi të kujfizuara nga punët që rrezikojnë apo dëmtojnë shëndetin apo zhvillimin e tyre psiko-fizik.

Në fund, ministri Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë p/ligj.

Opinionet, vërejtje dhe sugjerimet e veta i dhanë deputetët: Kolë Berisha, Sabile Basha, Zylfije Hundozi, Ramadan Kelmendi dhe Flora Brovina që i janë bashkangjatur stenogramit.

Pastaj kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon

Për-----91;

Kundër-----0;

Abstenime----0.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim P/ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe të mjedisit të punës. Kuvendi ngarkoi Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetues, Komisionin për Buxhet, Komisionin për Shëndetësi dhe Komisionin për Punë dhe Mirëqenie Sociale që ta shqyrtojnë këtë p/ligj në afatin prej tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime lidhur me të.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës-nr.2002/9.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Ministrisë të Punës dhe të Mirëqenies Sociale që ta arsyetonte para deputetëve këtë p/ligj.

Ministri Ahmet Isufi – Kuvendi i Kosovës e kamiratur Ligjin për Inspektoratin e Punës-nr.2002/9, më 19 dhjetor 2002, por disa dispozita të tij po shkaktojnë vështësi serioze në zbatimin praktik në punën e Inspektoratit të Punës.

Lidhur me këto vështësi, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale e ka njoftuar kryetarin e Kuvendit, Nexhat Dacin, me anë të një shkrese më 15 janar 2003, ku janë dhënë vërejtjet e Ministrisë lidhur me tri amendamente që i kishte inkorporuar në Ligj Kuvendi gjatë fazës së shqyrtimit dhe miratimit të Ligjit. Prandaj, Ministria përmes Qeverisë ka

bërë propozim që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i këtij Ligji, në mënyrë që ai të jetë më funksional dhe të zbatohet më lehtë në praktikë nga ana e Inspektoratit të Punës. Në fund, ministri Isufi i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratonin këto ndryshime dhe plotësimet në këtë Ligj.

Berat Luzha – në emër të Grupi Parlamentar të PDK-së, tha se e përkrahë këtë P/ligj që gjatë fazës së shqyrtimit të tij, eventualisht të plotësohet edhe me ndonjë amendament tjetër.

Besa Gaxheri në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, tha se këto ndryshime dhe plotësimet që i paraqet Ministria, Komisioni për Buxhetin ka diskutuar edhe gjatë fazës së shqyrtimit të p/ligjit dhe për ta këto ndryshime janë të papranueshme, ngase me anë të këtyre amendamenteve, sipas saj synohet centralizimi i pushtetit në Kosovë, kurse duhet të punohet për decentralizimin e tij.

Vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë p/ligj i dhanë edhe deputetët: Hydajet Hyseni dhe Fatmir Sejdiu.

Kryesuesi e vuri në votim p/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratit të Punës dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----38;
Kundër-----40; dhe
Abstenime 13.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi P/ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e punës.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare që do të mbahet më 11 shtator 2003.

Kryesuesi propozoi këtë

R E N D T Ë D I T Ë S:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për prokurimin publik në Kosovë;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit i pensioneve për personat me aftësi të kufizuara; dhe
3. Diskutimi i Kris Patenit, përfaqësuesi i BE-së.

Kuvendi e miratoi këtë rend të ditës.

Seanca përfundoi në orën 11:50 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat DACI